

URDHËR
Nr. 301, datë 8.5.2020

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 193, DATË
20.3.2020 “PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr.15/201,“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID -19 në Republikën e Shqipërisë,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë“, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pas pikës 3/1, shtohet pika 3/2 me përmbajtje:

“3/2 Lejohet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre, bizneset e mbyllura sipas listës bashkëlidhur Udhrit nr. 193, datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, sipas tabelës. 1 bashkëlidhur këtij urdhri, duke filluar nga data 11 maj 2020, brenda fashës orare 08:00-17:30.”

2. Shërbimet e përcaktuara sipas pikës 1, të këtij urdhri kryhen duke respektuar protokollat e sigurisë, të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij urdhri.

4. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor mbikëqyr zbatimin e urdhrin dhe vendos masën e gjobës, sipas legjislationit në fuqi.

5. Urdhrat e tjerë që bien në kundërshtim me parashikimet e këtij urdhri, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

Tabela 1

KODI NVE 2 DIGIT	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	STATUSI I AKTIVITETIT
50	Qendra Tregtare (përfshijë baret,restorantet dhe aktivitetet e destinuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve)	Lejohen
136	Aktivitetet të tjera shërbimi (Trajtime estetike, mireqenie fizike, përfshijë palestra) Këtu përfshihen aktivitetet të trajtimit të flokut dhe trajtime të tjera të bukurisë, të detajuara sipas Nomenklaturës së Aktiviteteve Ekonomike.	Lejohen